

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2023 , ora 11:10 në ambjentet e Subjektit “Imperial” mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese 2 N/Kr yetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, dhe Z. Artur Guni, specialistja e Nndihmës ekonomike si dhe media.

### Pika e 1-rë e rendit të ditës – Miratimi i rendit të ditës.

#### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pershendetje të gjithëve. Ka pasur disa parregullsi në lidhje me publikimin e shkresave ndërmjet rrjeteve elektronike që duhet të jenë në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.Këto parrëgullsi në komunikime për disa nga anëtarët e këshillit si dhe në disa publikime kanë ndodhur për arsy se ka qënë një muaj lejesh . Por mendoj që nga ky moment dhe në të ardhmen do jetë cdo gjë korrekte pra do të rregullohet kjo gje. Gjithashtu mbledhja e kryesise së këshillit bashkiak nëse deri tani kemi pasur biseda nëpërmjet telefonave, dhe biseda shoqërore, në të ardhmen do jetë shumë më korrekte si dhe do jeenë në përputhje me ligjin dhe rregulloren e këshillit. Për cdo mbledhje të kryesisë do mblidhem i në zbatim të rregullores. Në dosje kemi rendin e ditës.

#### Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.

Në rendin e ditës ka 3 pika. Mendoj se duhet të shtohet dhe një pikë tjetër e katërt.Presupozohet që ne jemi parlamenti i qytetit.Tek mbledhja e komisioneve u la që do të ketë komision auditimi. Pse keni frike nga komisioni auditit.

#### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Jo nuk u la komision audit, por u la të perfshihet tek komisioni i ekonomisë. Ti kalove direkt tek pika e fundit. Komisionet u miratuan. Por mos flisni pa leje. Cfarë lidhje ka rendi i ditës tani. Ai u miratua një hërë.

#### Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.

Nuk e kuptoju frikën tuaj për këtë komisyon, pastaj këtu sot duhet të ishte prezent dhe kryetari i bashkisë.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Janë 2 N/Kryetarët e Bashkisë këtu dhe nuk ka nevojë për kryetarin. Kryetari Bashkisë ka dhe angazhime të tjera. Të miratojmë rendin e ditës më parë pasta të shikojmë pikat vec e vec.

### **Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.**

Nuk miratohet rendi i ditës pa u diskutuar me parë ky problem.

### **Ilirjan Sadiku – antar i këshillit bashkiak**

Vazhdo me rendin e ditës.

### **Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.**

Duhet ta mbash ti rradhën. Jo këta të Partisë Socialiste.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Ti fole pa leje dhe une nuk po them gje.

### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

1.Tek shume këshilltarë i dergova një memo dje ne lidhje me rendin e ditës se sotme, ku sipas rregullores së Këshillit Bashkiak,neni 77 pika 5 saknksionon faktin që ne duhet të paisemi me dokumentacionin përkatës dhe kërkesat , relacionet, dokumentacionet tona t'i dorëzojmë tek ju. Po nuk u pajisëm me dokumentacionin përkatës kjo mbledhje sot juridikisht quhet nul.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Më duket kërkova ndjesë `për këtë pasi kemi pasur problem

### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Nuk është cështje ndjese, është cështje dinjteti dhe nuk ka lidhje punon faqja s'punon faqia.Unë memon e kam derguar dje për të gjithë, dhe mendoj e keni lexuar të gjithe. Pavarësisht se nuk pati asnjë reagim nuk ka problem. Rëndësi ka që e keni lexuar dhe jeni të qarte tek ajo qe unë kam thene.

2.Kthehem i tek pjesa e rendit të ditës. Me forcën e kartonit do vazhdohet të miratohet rendi i ditës Si ekonomiste, financiere, njoħese e ligjt dhe audituese e brendshme e certifikuar, ja ptem nje llogjikë për heqien e komisionit të auditit.

Llogjika është kjo, auditimi ka një llogjikë që vepron nga poshte lart, që do të thotë që Bashkia ka një diskater që merrety me auditimin e brendshem.Këshilli bashkiak si organ vendim marrës duhet ta ketë këtë komision audit, dhe të dyja

bashkë japin llogari tek KLSH-ja.Kur të vijë KLSH-ja nesër nuk mund të më kërkojë llogari mua si këshilltare, apo juve si kryetar dhe të gjykojë në mënyrë individuale. Ne duhet të kemi një organ i cili në mënyrë të pavarur të auditojë misionin e komisionit te ekonomise dhe buxhetimit.Nuk mundem une pjese e këtij komisionit ekonomik të vendos se si do i shpenzoj financat e mia dhe të ardhorat,dhe pastaj të vetëkontrollohem, se kjo pastaj është një konflikt interesit skandaloze dhe jashtë cdo llogjike.

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Ky është mendimi juaj.

#### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Ky nuk është mendimi im, këtë e thotë ligji, pra ka një ligj për auditimin e brendshëm i cili përcakton kompetencat, që jane kompetencat vendimmarrëse dhe ato kontrolluese, prandaj ekzistojnë organet, për t'u ndarë vendim-marrja nga kontrolli.

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Asgjë nuk e pengon ngritjen e komisionit të auditimit. Gjithkush që mund të ketë një indicie mund të beje gjithshka.

#### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Prandaj duhet me patjetër komisioni i auditimit.Për mos me thënë pastaj që është skandaloze fakti që transparenca është bashkuar tek komisioni i mjedisit, bujqësise, veterinarisë e menaxhimit të ujrave.Kjo është qesharake. Ka mënyra të tjera për ta zgjidhur.

3.Vëmë re nga mbledhja e kaluar në të cilën unë nuk isha prezente do doja shumë të dija se çfarë ndodhi.Sot ekzistojnë të gjitha mënyrat për t'i përshfaq aktivitetet tonë.Live nuk do të mungojë asnjëherë.Nuk jemi këtu për t'i dhënë llogari vehtes, apo njëri tjetrit apo për të bërë debate boshe. Këtu na kanë mandatu qytetarët dhe për aq kohë sa na kanë mandatu qytetarët dhe nuk na dëgjojnë për ato që bëjmë dhe për ato që themi, kështut që përvèc publikimit të akteve që është e detyrueshme me ligj në faqen zyrtare të Bashkisë, gjithashtu ligji për informimin publik thotë aty ku ka edhe mjete të tjera informacioni, dhe mjeti kryesor i informacionit sot është live. Live, e rrjetet sociale dhe për aq kohë sa del Kryetari i Bashkisë aq kohë duam edhe ne. Unë kam për detyrë që të bëj memon time.

#### **Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.**

Të gjitha mbledhjet duhet të bëhen live.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Mendoj se dy nga këto që ti the unë i thash në fillim të mbledhjes. Do ta kemi në konsideratë. Mund të vazhdoni Z. Sekretar me listë prezencën.

**Elvi Cuni - Sekretar i Këshillit Bashkiak:**

Bën apelin e këshilltarëve. Marrin pjesë 43 anëtarë të këshillit bashkiak.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Nga lista e PS mungojnë 4, BF 2, PD 2.

Kuorumi është vazhdojmë me rendin e ditës. Lexon pikat e rednit të ditës.

E hedh në votim rendin e ditës.

Këshilli bashkiak me 43 vota pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak



Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



## **PROÇESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 31.08.2023 , ora 11:10 në ambjentet e Subjektit "Imperial" mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjesë 2 N/Kr yetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, dhe Z. Artur Guni, specialistja e Nndihmës ekonomike si dhe media.

### **Pika 2 dhe 2/1 e rendit të ditës**

**Pika 2-të e rendit të ditës – Dhënia e Nndihmës Ekonomike nga fondi Bashkisë për muajin Korrik 2023.**

**Pika 2-të e rendit të ditës – Dhënia e Nndihmës Ekonomike nga fondi kushtëzuar për muajin Korrik 2023.**

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Ftojmë një përfaqësuese të bashkisë.

Ermira Lico – Specialiste për ndihmën ekonomike ne Drejtoine e NE.

Dhënia e ndihmës ekonomike nga fond i bashkisë: për muajin korrik janë 97 familje me një fond prej 260300 lekë, ndërsa nga fondi i kushtëzuar janë 279 familje me një fond prej 1276500. Fondi i kushtëzuar është i bazuar mbi çiftëzimin e pikëve të fondit total të familjeve aplikante në sistemin e ndihmës ekonomike. Nëse duhet tju jap ndonjë sqarim më tepër nga sistemi i ndihmës ekonomike?

### **Z. Blendi Himçi – Antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit BF.**

Për muajin tjetër të kemi një informacion sa kanë qenë përsituesit e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë dhe fondi i kushtëzuar që nga muaji Janar deri në muajin që do të miratohet herën tjetër.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

I hedh në votim pikën 2 dhe 2/1 të rendit të ditës.

Këshilli bashkiak me 43 vota pro, kunder, abstenum nuk ka, miraton sa më  
sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2023 , ora 11:10 në ambjentet e Subjektit “Imperial” mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjesë 2 N/Kr yetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, dhe Z. Artur Guni, specialistja e Nndihmës ekonomike si dhe media.

**Pika 3-të rendit të ditës –Për ndrushimin e VKB Nr. 22 datë 26.02.2020 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit Bashkiak Elbasan.**

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Ne e diskutuam edhe në mbledhjen e parë dhe pati debat lidhur me cfarë diskutuam për të bërë ndryshimin nga 19 komisione në në 14 që ne kemi vendosur. Nisur nga disa shqetësime ne organizuam dje një dëgjesë publike. Sekretari Këshillit mund t’ju japë një informacion për këtë.

**Altin Meçja – antar i këshillit bashkiak.**

Kisha edhe unë një kërkesë me publikun.

**Enerieta Ferra – N/Kryetare e Këshillit Bashkiak.**

Dëgjesa u zhvillua më datë 30.08.2023 në ambjentet e subjektit “Imperial.Ka qënë tek faqa e facebook dhe në faqen e bashkisë.

**Vabona Balliu – antare e këshillit bashkiak**

Duhet të keni parasysh që këshiilli ka ndryshuar. Njoftimet nuk bëhen as tek faqa e bashkisë as në facebook por në faqen e këshillit bashkiak.Faqja e këshillit bashkiak është shumë e rëndësishme, nëse jeni mësuar me bebelushat e partsë, nuk ka më. Këshilli Bashkiak ka ndryshuar jeni me opozitë dhe bazur në ligjin dhe në Kushtetutën e Shqipërisë të cilën duhet ta zbatoni, duhet të mësoheni ta respektoni atë.

**Afrim Qosja – antar i këshillit bashkiak**

Njoftimi është bërë tek faqja e këshillit bashkiak.

**Elvi Çuni - Sekretar i Këshillit Bashkiak**

Njoftimi është bërë më shumë se një javë përpara në faqen e këshillit bashkaik., është bërë publik në stendat e bashkisë gjithashtu sipas rregullores dhe në faqen social media të rrjeteve sociale të këshillit bashkiak nga stafi i sekretariatit të këshillit bashkiak. Mbledhja ka qenë e hapur, mund të merrte pjesë kushdo.Për shkak se unë kam qënë me leje të zakonshme, ndoshta kam harruar t'jua sjell në grupin e ëhats up-it tuaj. Çdo gjë është shumë lehtë e verifikueshme. Ishte procedurë që ju e votuat në parim gjithë përberjën e komisioneve edhe mbledhjen që shkoi

#### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Ne kemi një grup ëhats up që ka një funksion informativ dhe nuk është procedurë dëgjesa publike, që ne duhet të jemi atje për të mbaruar punë. Dëgjesa publike bëhet me qëllim që publiku të vihet në dijeni që po i preken interest dhe e dyta që të ndërhyjë në ënyrë positive për të rregulluar interest e veta, prandaj bëhet dëgjesa publike.

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Në rregulloren e këshillit bashkiak lidhur me caktimin dhe numrin e komisioneve, është kompetencë e kryetari të këshillit që të propozonte , sigurisht mbi bazën e konsultimeve qe do të ketë me kryetarët e grupeve të këshllit. Dhe ndryshimi tjetër i rregullores, thuhet se nëse do të ndryshohet numri kjo bëhet me konsultë dhe me dëgjesë me publikun. Dëgjesën me publikun ne e zhvilluam dje. Ndersa mbledhjen e kaluar ne arritëm deri ne zgjedhjen e grupeve për të caktuar kryesinë e seilit.

#### **Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak**

Jo nuk u caktua në të gjitha komisionet.

#### **Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Ka pasur një feedback ky konsultimi public. A mund të na bëhet prezent çfarë u vendos nga publiku që ta dimë dhe ne.

#### **Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak**

Pra publiku nuk kërkoi komison kontrolli. I vetmi publik i zgjedhur nga ju i beson totalisht bashkisë?

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Eshtë bërë një dëgjesë publike dhe nuk ka pse të debatojmë bashkë, kaloj tek projekt vendimi i pikës tre.

### **Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak**

Ai komision ekziston në Bashkinë e Tiranës.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Në asnjë bashki nuk ekziston. Pika tre e rendit të ditës është të miratojmë përbërjen e komisioneve të përheshme sipas listës bashkangjitur.(i lexon). Çdo komision do jetë me 7 anëtarë, gjithashtu keni dhe listën e anëtarëve zëvëndësuës pér të përcaktuar.

### **Z. Blendı Himçi – Antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit BF.**

Ju relatuat, por pér ndryshimin e rregullores duhet të na jepni edhe ne fjalën pér diskutim para se të votohet.

I nderuar kryetar i këshillit bashkiak, të nderuar nënkyetarë të bashkisë, të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak.

Së pari më lejoni të them që vërtet forca e kartonit e shumicës mund të bëjë çudira por që sigurisht nuk mund të shkeli ligjin dhe nuk mund të kapërcej ligjin.Dhe ja ku jemi sot prap në mbledhjen e rradhës ku jemi rikthyer përsëri pér të ribërë edhe njëherë tjetër ashtu siç diskutuam edhe në mbledhjen e mëparshme të këshillit bashkiak pikërisht ajo që quhej ndryshimi i rregullores dhe më pas të krijuar komisione të këshillit bashkiak. Padisktutim që shkelja e gjithë rregullores, dhunimi i rregullores me votat e shumicës së këshillit nuk bëri asgjë dhe u rikthyen përsëri sepse instrumentat kontrollues sic është institucioni i Prefektit bëri që tua kthej këtë lloj akti, dhe unë e falenderoj Prefktin nga ana ime që pikërisht e ka risjellë dhe njëherë materialin.

Nga ana tjetër ajo që dua të shtoj është se nëse shohim ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” në nenin 18 thuhet - “Seancat e këshillimit me bashkësinë dhe në seancat e këshillimit pér bashkinë i referohet këshillimit me publikun dhe thuhet këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut sipas shqyrtimit të akteve zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë të cilat janë të detyrueshme pér rastet e parashikuara në nenin 54 shkronjat a,dh,e,f,k dhe nenit 77 por nuk na intereson, na intereson pika “k” e nenit 54 ku thuhet se këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca , miraton norma standarte dhe kritere pér rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligji si dhe mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik. Pra ndryshimi i rregullores kërkon një konsultim publik. Ju thoni që ne e bëmë.Nëse ju e keni kthyer këtë pér të dhunuar këshillin bashkiak, pér të ofenduar KB, dhe pér të thënë që u bë konsultimi pa dijenisë e këshilltarëve, të paktën të informimit të këshilltarëve, kjo nuk është e rregullt pasi konsultimi kërkon jo pér tu mbledhur në këtë sallë formalisht, por konsultim të gjerë pér

shtrirjen territorial që ka bashkia e Elbasanit. Jeni në shkelje dhe dhunim të rregullores, kjo e parë në aspektin procedural. Por e parë nga ana tjetër në aspektin e ndryshimit që po i bëni rregullores, unë e kuptoju që ju do përdorni përsëri mungesën, verbërinë e kartonit pa e bazuar këtë në ligj por sigurisht pavarësisht se jemi në opozitë ne na takon e drejta e fjalës dhe e drejta e dhënieve së mendimit ndryshe, bazur dhe përputhur në ligj por sigurisht edhe në rregullore. Ajo që konstatoj aktualisht me keqardhje është se nuk e kuptoju pse keni frikë nga komisioni i auditimit kur pikërisht ju keni një drejtori të ausitit të brendshëm dhe zakonisht komisionet janë ngritur dhe në funksion të drejtoreve përkatëse. Pa diskutim ky audit që e përcakton ligji për vetqeverisjen vendore nga kush komision do të jetë i varur, kush komision do ta kontrolloj këtë lloj drejtorie sepse nuk ekziston e keni fshire dhe nuk e kuptoju arsyen se pse para katër vitesh dhe gjate gjithe jetes së këshillit bashkiak ka ekzsistuar ky komision dhe pikërisht del një ditë që ju nuk kërkonit të kontrolloheni, nuk kerkoni të keni audit të brendshëm. Unë e kuptoju që këto kater vjet keni ecuar zbathur dhe ndoshta këto sandalet që është opozita e KB kanë filluar tju shtrëngojnë padiskutim që do ju shtrëngojnë edhe më shumë por unë e ftoj bashkinë, kryetarin e bashkinë por dhe këshilltarët që të përdorin llogjikën dhe ti jepin të drejtën e demokracisë dhe të mirëfunksionimit të punëve të bashkisë se padiskutim KB është edhe një valvul garancie dhe sigurie për të parandaluar shkeljet dhe abuzimin që mundet në një mënyrë apo në një tjeter të bëhet nga administrata e bashkisë. Ftoj dhe njëhësëtë të përdrim llogjikën përsa i përket futjes dhe ngritjes së komisionit të kontrollit financiar. Ju faleminderit.

#### **Z. Zamir Muzhaqi- N/Kryetar i këshillit bashkiak**

Ju përshëndes të gjithëve. Në bazë të diskutimeve të rendit të ditës pikës tre profesoresha dhe kryetari i grupit dhanë mendimin e tyre. Mbeshtes llogjiken ligjore dhe bëj një propozim. Qe rendit të ditës ti shtohet dhe komisioni i audititmit dhe kontrollit financiar. Është për të mirën e punës jo për sherret e përditshme.. për të mirën e bashkisë dhe tonën si vendimarrës për bashkinë e Elbasanit. Mabjenu në procesverbal dhe ta hedhim në votim .

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Kalojmë në votimin e projekt vendimit të pikës 3.

#### **Dritan Cepa – antar i këshillit bashkiak.**

Cfarë do votojmë projekt-vendimin e paraqitur apo propozimin e Z. Muzhaqi.

#### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Do votojmë rendin e ditës, pra projekt vendimin e paraqitur, pastaj do votojmë propozimin e Z. Muzhaqi.

**Dritan Cepa – antar i këshillit bashkiak.**

Nuk m und të miratohet projekti i paraqitur dhe pastaj propozimi pasi nuk ka më vlerë votimi.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Hedh në votim materialin e paraqitur, pra projekt-vendimin.

Vota pro .....

**Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Si miratohet materiali i rendit të ditës, kur ke propozim të paraqitur për ndryshim rendi dite.

**Ilirian Sadiku - antar i këshillit bashkiak.**

Në dëgjesën publike nuk e deshi publiku komisionin e auditimit.

**Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak**

Kjo që beni ju s'ka llogjikë juridike. Pse keni frikë nga komisioni i auditimit?

**Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak.**

Edhe Bashkia Tiranë ka komision auditi

**Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.**

Z. Lala për cdo ndryshim, shkelje ligjore apo administrative, ti nuk ia heq të drejtën këtyre këshilltarëve të kërkojnë llogari si drejtoreve apo dhe kryetarit të Bashkisë.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

E hedh në votim propozimin e Z. Zamir Muzhaqi “Të shtohet në rend të ditës - Krijimi i Komisionit te Auditimit”

**Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.**

Cdo gje duhet e argumentuar dhe të bëhet transparente, që nesër kur të përballemi në Gjykatë të kemi argumenta. Ajo Zj. e sekretariatit është e detyruar që cdo objekzion apo argument, që paraqësim unë apo shokët e mi ta pasqyrojë. Unë do ta mbroj veten time para ligjit.Kjo gjë është në të mirë të të gjithëve, dhe kryetarit të bashkisë i pari.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Rezultati votimit për propozimin e Z. Muzhaqi:

Këshilli bashkiak me 15 vota pro, **26 vota kunder**, 2 abstenim - nuk e miraton propozimin e mësipërm..

**Votuan pro** - Blendı Himci, Rudina Mita, Andi Shtylla, Doris Madhi,Ergys Muzhaqi, Mimoza Trimi, Dritan Cepa,Valbona Balliu, Artan Kana, Armonela Marku, Aurora Domni,Majlinda Kaculi,Zamir Muzhaqi,Bjanka Copja, Altin Mecja.

**Abstenuan** – Erion Murataj, Lumturi Hasa.

**Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak.**

Ju me forcën e kartonit mund të bëni cdo gjë, por ne këtu nuk jemi kot.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Tërheq vëmëndjen Z. Ergys Muzhaqi për formën jo korrekte të komunikimit me këshilltarët.

Hedh në votim projekt vendimin e paraqitur të pikës 3 tek rendi i ditës.

Këshilli bashkiak me **28 vota pro**, 15 kundër, abstenim nuk ka – miraton sa më sipër

**Votuan kundër** - Blendı Himci, Rudina Mita, Andi Shtylla, Doris Madhi,Ergys Muzhaqi, Mimoza Trimi, Dritan Cepa,Valbona Balliu, Artan Kana, Armonela Marku, Aurora Domni,Majlinda Kaculi,Zamir Muzhaqi,Bjanka Copja, Altin Mecja.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

## **PROÇESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 31.08.2023 , ora 11:10 në ambjentet e Subjektit "Imperial" mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese 2 N/Kr yetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, dhe Z. Artur Guni, specialistja e Nndihmës ekonomike si dhe media.

**Pika 4-tërt e rendit të ditës – Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak dhe përberjes së tyre.**

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Vazhdojmë me zgjedhjen e kryetarëve, Zv/Kryetarëve dhe Sekretarëve të komisioneve.

Vazhdon mbledhja e komisioneve për zgjedhjet e kryetareve, n/kryetareve dhe sekretarëve.

**Altin Mecja – antar i këshillit bashkiak**

Na tregoni shkakun dhe 1 argument ligjor pse u hoq komisioni i auditit?

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Nuk u hoq komisioni auditit por u përfshi tek ai i ekonomisë. Sekretari këshillit të lexojë zgjedhjet që keni bërë.(Vazhdon leximi deri tek Komisioni i Sherbimeve dhe Strehimit Social, Shëndetësisë dhe Barazisë Gjinore, pasi ndërpritet nga Valbona Balliu.)

**Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.**

Unë e kundërshtoj zgjedhjen për këtë komision. Nëqoftë se ju keni vendosur të shkelni rregulloren unë po largohem.Këtë komision unë e hedh në diskutim pasi Ju këto pazare të vogla nuk mund t'i bëni me mua. Sipas rregullores nuk e përcakton ti kryetari apo n/kryetarin e sekretarin. Unë e kundërshtoj. Ju e bëni me forcën e kartonit por unë do e kundërshtoj tek Prefekti me argumenta l;igjorë.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Ne po zbatojmë rregulloren.

**Elvi Cuni – Sekretari i Këshillit Bashkiak.**

Vazhdon leximin për pjesën e mbetur.

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.**

Hedh në votim pikën 4 të rendit të ditës së bashku me zgjedhjet e kryetarëve, n/kryetarëve dhe sekretarëve të komisioneve.

Këshilli bashkiak miraton me shumicë votash.


Në votim nuk morën pjesë Blendi Himci, Rudina Mita, Ergys Muzhaqi, Valbona Balliu pasi u larguan më parë.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak



Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

